33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jenc të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrimja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktoar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuhët në përdorim zyrtarë
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10 % e vlerës së kontratës ose 6,100.00 € me validitet prej 90 ditëve ose 15.11.2023.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i> ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i> ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i> ; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[shëno shumat]</i> (ii) të personave të tjerë: <i>[shëno shumat]</i>
Programi	12.1	Planin për Menaxhimin e Kontratës. Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 2 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është 2 ditë nga data e pranimi të kërkesës së Menaxherit të projektit
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë : Dy ditë pas nënshkrimit të kontratës, ne konsultim me menaxherin e projektit)
	17.2	Përfundimi i punëve bëhet sipas planit të menaxhimit të kontratës 60 ditë kalendarike, ose deri me date 15.10.2023.
Dëmet e likuiduara	19.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.10% e Çmimit final të Kontratës në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahet nga ana e kontraktuesit
Inspektimi dhe testimi	22.1	Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së punëve do të bëhet në momentin e dorëzimit që janë lëndë e kësaj kontrate, nga Komisioni i Pranimi të punëve – shërbimeve, i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor

		Administrativ të Autoritetit Kontraktues. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i punëve-shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Komisionit të Pranimit të punëve-shërbimeve të Autoritetit Kontraktues.
Pagesa		Sipas Raportit të prezantuar – dorëzuar nga Menaxheri i Projektit- situacioneve të aprovuara nga ana e Organit mbikëqyrës, kurse pjesa tjetër e pagesës do të realizohet pas perfundimit të punimeve të percjellura me raport nga ana e menaxherit të kontrates dhe raportit nga ana e komisionit të pranimit teknik të projektit. Menagjer i projektit nga AK është: Flurim Krasniqi Menagjer mbikqyrës i kontrates nga AK është: Zeni Krasniqi Menagjer i projektit nga OE është: Arian Bytyqi
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagesë paraprake.
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: E vlerës së kontratës.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë [shëno numrin] ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është : 12 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm. Dokumenti Polisa e sigurimit të kualiteti të lëshuar nga një Bank apo kompani e sigurimeve e licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës 10 % vlerën e përgjithëshme të kontratës, me afat validiteti për prej 12 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin në Kosovë. b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të

		kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.
--	--	--

Ruzhdi Berisha
"Triangle"

A.	RENOVIMIT I SHKOLLËS SHM „RUZHDI BERISHA " NË DRAGASHI
----	--

PUNËT PËRGATITTORE					
I					
POS	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
	Masa e sigurisë: Duhet të jenë në nivelin më të lartë për arsye të rrejtjes së shëndetit të personave që punojnë dhe jetojnë afër punishtes. Pra në këtë mënyrë duhet të bëhet rrethimi sa më i mirë i punishtes dhe vendosjes së materialeve në të si dhe të mirën masat e nevojshme të sigurisë (preventiva) hapësinore në mes të zonës nën ndërtim dhe zonave të tjera të cilat mbeten në shfrytëzim gjatë fazës së punimeve. Materialet nuk duhet të dalin jashtë rrethojës së punishtes. Punishtja të rrethohet me tabela prej hamarine dhe me konstruksion të përfortuar mirë në tokë. Para fillimit të punimeve punëkryesi duhet që në kosto të parashtes edhe çkyqjen e instalimeve ekzistuese në fillim të ekzekutimit të punimeve si dhe rikyqjen e instalimeve pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe masat e nevojshme për konservimin të instalimeve ekzistuese të cilat ngelen në shërbim (funksion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve. Për çdo ndryshim të mundshëm në projekt gjatë realizimit të punimeve duhet të konsultohet organi mbikëqyrës dhe projektanti. Për secilin pozicion ku janë përmendur karakteristikat teknike të prodhuesit mund të përdoren materiale me karakteristika të ngjajshme të prodhuesve të ndryshëm në përputhje me standardet IX dhe ISO.				
1.1	Signurimi i punishtes. Signurimi të bëhet përmes shenjave përkatëse të cilat krijojnë signi dhe zhvillim normal të punimeve në gjithë orarin sa zgjasin punimet sipas kërkesave të investitorit. I.log në komplet	komplet	1.00	400.00	400.00 €
1.2	Dislokimi si dhe bajtja e inventarit të shkollës tavolina të punës, karrike si dhe të gjitha pajisjet tjera në një kthim të objektit të shkollës. I.logaritur në komplet.	komplet	1.00	500.00	500.00 €
1.3	Mbrojtja e zdruthtarit të mbrendeshme dhe të jashtme në objekt, dritareve dhe dverve, Mërmëret e granitet në koridore ,pajisjeve të navigimit (Kamerave) ,inventari dhe elementeve tjera dekorative në murte e shkollës e në koridore ,në ato vende ku nuk janë parapar riparime dhe sanime për të parandaluar dëmtimet fizike gjatë ekzekutimit të punimeve. Signurimi të bëni me Dy shtresa nga folia e PVC I.logaritja për e sipërfaqeve të murit të mbuluar me mbrojtje I.logaritja për	komplet	1.00	900.00	900.00 €
Gjitheshejt punime përgatitore:					1,800.00 €

PUNËT E DEMOLIMIT DHE RRËNIMIT					
II					
POS	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
	Punëmarësi është i detyruar që të gjitha materialet e demoluara (sipas pos. të poshtëshënuara) të largojë nga punishtja apo të transportojë deri në deponinë e caktuar për deponim materialeve. Materialet që i nevojiten shkollës duhet të deponohen në depot e parapara për grumbullim të materialit në depot e shkollës.				
2.1	Furnizimi me amballazh mbrojtës , dhe paketimi me kujdes i gjesendeve me vlerë në zonë ku do të rinovohet ,duke përfshirë bartjen dhe lëvizjen e mobiljeve ekzistuese duke u kujdesur që mos lëndohen dhe kthehen në gjendjes të mëparshme pas përfundimit të punimeve. Mobiliet si dhe gjerat me vlerë të amballazhuara , gjatë kryerjes së punimeve duhet të depozitohen (Magazinoohen) në zonë të sigurie. Në çmim I.log komplet	komplet	1.00	3000.00	3,000.00 €
2.2	Demontimi i rrjetit ekzistues të ujësjellesit dhe kanalizimit. Në çmim të parashihet edhe lidhja alternative e pjesëve që do të mbesin në funksion. Në çmim I.log komplet zona që trqjtohet	komplet	1.00	2500.00	2,500.00 €
2.3	Demontimi i pajisjeve ekzistuese hidro-sanitare të ujësjellesit dhe kanalizimit. Në çmim të parashihet edhe bajtja transporti dhe largimi në vendin e caktuar. Materiali i demoluar është prone e Investitorit. Në çmim I.log komplet elementet perçiellesë të një pajisje. I.log në copë	copë	14.00	25.00	350.00 €
	Demontimi i dverve ekzistuese me dimensione të ndryshme si dhe bartja e tyre deri në deponinë e caktuar nga organi mbikëqyrës. Në çmim I.log copë				

2.4	Dim 70/205 cm.	copë	4.00	50.00	200.00 €	✓
	Dim 90/205 cm, me mbi dritare	copë	2.00	300.00	600.00 €	✓
2.5	Demolimi me kujdes 1 pllakave keramike nga muret në nyjet sanitare. Pllakat duhet te largohen dhe bartja e materialit te demoluar deri ne deponi. Llogaritja e demolimit të në m2	m2	75.90	0.10	7.59 €	✓
2.6	Demolimi me kujdes 1 pllakave keramike nga dyshemet në nyjet sanitare pllakat se bashku me shtresen rrafshuese dhe bartja e materialit te demoluar deri ne deponi. Llogaritja e demolimit të në m2	m2	24.40	0.15	3.66 €	✓
2.7	Demolimi me kujdes 1 mureve me trashesi te ndryshme (t = 25cm :20cm, 12cm). Nga blloqet e zgavruara me suvatime në të dy anët Ne çmim te parashihet edhe transporti i materialit te demoluar deri ne deponi. Llogaritja e demolimit të në m2	m2	35.60	1.00	35.00 €	✓
2.8	Demolimi me kujdes 1 traut beton arme ne perimenter te mureve qe do te demolohen. Dimensionet e traut jane 20/25cm dhe 20/12 m77 nivelin 2.15 cm nga niveli i dyshemeve. Llogaritja e demolimit të në m1	m1	10.55	1.50	15.83 €	✓
2.9	Demolimi - geryerja e suvase ekzistuese me kujdes nga muret dhe pllafonet dhe bartja e materialit te demoluar deri ne deponi. Llogaritja e demolimit të në m2	m2	163.50	0.10	16.35 €	✓
Gjithsej punët e demolimit dhe rrenimit:					6,728.43 €	✓

III		PUNËT E MURATUESEVE				
POS	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej	
	Blloqet giter duhet të jenë të cilësishë së lartë , me vrina të përstatshme , të pjekura mirë pa prezencën e gëlqerës dhe salitrit . Brumi apo qulli argjilior me të cilin krijohen blloqet duhet të jetë i pastër pa prezencë të materialeve organike. Pregaditja e bazës për muratim , fillimisht duhet të largohet pluhuri mbetjet , hudhet llaqi i mjaftueshem për ti mbushur vrinat e blloqeve giter, po ashtu lidhjet horizontale dhe vertikale të jenë në vijë të drejtë dhe e mbushur mirë . Në punën përfshihet edhe ndërtimin e skelës . Llogaritja caktohet në bazë të normave ndërtimore të shprehura në m2					
3.1	Furnizimi me material dhe muratimi i murit të depos te objektit te tualeteve me blloqe me vrina me dimensione 12x19x25 cm, si dhe mbushje me llaq çimentoje me konsistencë të raportit 1:2:6. Muratimi i murit bëhet me trashësi 12 cm , para vendosjes së blloqeve për muratim duhet të pastrohet dhe hudhet ujë. Pas mbarimit të lidhjes dhe mbushjes së fugave , lidhësi i tepërt pastrohet deri në thellësin 2 cm. Në çmimi te llogaritet edhe shitangimet horizontale ne naltësin 2.15 m nga betonarme C-20/25 dhe 4ti 12 mm dhe stafa fi 8/20 cm.Llogaritja caktohet në bazë të normave ndërtimore të shprehura në m3 ku përfshihet edhe montimi i skeleve.					
	t = 12 cm	m3	1.00	15.00	15.00 €	
3.2	Furnizimi me material, transporti si dhe punimi i suvatimit te mureve te brendeshme te ere mbrojtësit dhe tualeteve , me llaq ne dy shtresa ,me sperkatje te me parëshme nga llaqi i rrall i qimentos si dhe neper qoshe te vendosen kende nga metali .Siperfaqer duhet te jen te rrafeshta dhe te gjitha kendet e jashtme dhe te brendeshme ne formen e rregullt.Llog. në m2	m2	94.65	2.00	189.30 €	
3.3	Furnizimi me material, transporti si dhe punimi i suvatimit te pllafoneve te kthimave të objektit me llaq gëlqeror ne dy shtresa ,me sperkatje te me parseshme nga llaqi i rrall i qimentos .Siperfaqet duhet te jen te rrafeshta dhe te gjitha kendet e jashtme dhe te brendeshme ne formen e rregullt.Ne çmim duhet te llogaritet edhe vendosja e rrjetes per pengimin e plasaritjeve.Llog. në m2	m2	27.40	2.50	68.50 €	
Gjithsej punët e muratueseve					272.80	

IV PUNIMET E ZDRUKTHTARIS (DYER, DRITARE DHE PANELE NDARËSE)					
POS	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej

	Para furnizimit , paraprakishtë duhet kontrollohen të gjitha masat ndërtimore të dyerve dhe dritareve nga brenda dhe jashtë . Në çmim përfshihet të gjitha punët e muratimit dhe në mbushjen e vrimave dhe finalizimin e vendosjes së tyre.				
4.1	Furnizimi si dhe punimi i PVC zdruktharis se dyerve të mbrendeshme dhe te jashtme me min 8 cm profil me min 6 komora dhe tre digtuma gome,dhe shtangim nga profili metalik min 2 mm,dy fisht e mbushur me gaz argon ,gjami (44 1614) mm,Vinkhaus ose roto mekanizem.Dyert duhet te jenë shtanguara me elemente metal te fiksuara.Dyert duhet te kene mekanizma te cilit mundesojn hapje normalishte, dhe ate sipas standardeve.Dera duhet te kete brave me cilindër dhe tre celsa.Të gjitha të punohen sipas skemave te zdruktharis.Derë e mbrendeshme me dim 90x210 cm	copë	2.00	200.00	400.00 €
4.2	Furnizimi transporti dhe punimi i paneleve ndarëse të kabinave të toaleteve nga panele "Mediaplan" të punuara në korniza , profile alumini dhe të ngritura me mbështetëse (këmbë alumini) nga dyshemeja për 10 cm. Trashësia e paneleve ndarëse T= 15 mm. Përforcimi, anketimi i paneleve bëhet direkt në mure dhe dysheme mbi pllaka qeramike. Profilet këndore duhet të jenë të njatueshme për të montuar dyert nga materiali i njëjtë Panelet kan dimensione 150x200x1.5 cm,log në m2	m²	3.60	90.00	324.00 €
4.3	Furnizimi transporti dhe punimi i dyerve të brendshme të toaleteve , mbrenda hapësirave të toaleteve .Dyert të jenë të punuara si edhe paneleve ndarëse nga panele "Mediaplan" të punuara në korniza , profile alumini dhe të ngritura me mbështetëse nga dyshemeja për 10 cm. Trashësia e dyerve nga panelet Mediaplan T= 15 mm. Dyert të jenë të paisura me bagllan , rezë dhe qelës për mbyllje nga brenda. materiali i njëjtë me panelet ndarëse.Dyert kan dimensione 80x200x1.5cm.	copë	4.00	300.00	1,200.00 €
4.4	Furnizimi si dhe punimi i PVC zdruktharis se Dritareve dhe Vitrinave me min 8 cm profil me min 6 komora dhe tre digtuma gome,dhe shtangim nga profili metalik min 2 mm,dy fisht e mbushur me gaz argon ,gjami (44 1614) mm,Vinkhaus ose roto mekanizem.Dritaret duhet te jenë shtanguara me elemente metal te fiksuara.Dritaret duhet te kene mekanizma te cilit mundesojn hapje normalishte, dhe ate sipas standardeve.Dritarja duhet të punohen sipas skemave te prezentuara.dim 384x110 cm	copë	1.00	395.00	395.00 €
Gjithsej punët e Zdruktharis:					2,319.00 €

V	INSTALIMET E UJËSJELLËSIT				
POS	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
5.1	Furnizimi, me material te nevojeshem transporti dhe montimi i instalimit i tubave plastikë HDPE Per shperndarjen e ujit 1/2 "në pjesën e Toaleteve me të gjitha elemente përcjellëse fazonike, sipas zgjidhjes te prezentuar ne dokumentacionin teknik Në çmimi llogariten te përfshihet edhe vendosja e nje kutie shperndares si dhe valvulat per leshuarje dhe ndalje te ujit si edhe depërtimet neper mureve dhe lidhje me rrjetin ekzistues në toalete,log në komplet	komplet	1.00	4500.00	4,500.00 €
Gjithësejt punime të ujesjellesit:					4,500.00 €

VI	INSTALIMET E KANALIZIMIT				
POS	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
6.1	Furnizimi, transporti dhe instalimi i tubave PVC të profileve të ndryshme, (150;175 dhe 210) ne kanalizimin e mbrendeshem me uje mbledhese horizontal sipas zgjidhjes te re te krijuar te prezentuar ne dokumentacionin teknik si lidhja me rrjetin ekzistues te kanalizimeve në ndërtesë. Në çmimi llogariten edhe depërtimet neper e mure dhe lidhje me rrjetin ekzistues në toalet si dhe rehabilitimin e mureve,log komplet	komplet	1.00	4000.00	4,000.00 €
Gjithësejt punime të kanalizimeve:					4,000.00 €

VII	PUNIMET E SANITARISË				
POS	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
7.1	Blerja, transporti dhe instalimi i një lavabo i kompletuar me rubinet dhe elementë lidhës përcjellëse për ujë të ftohtë. I.log komplet	komplet	5.00	250.00	1,250.00 €
7.2	Blerja, transporti dhe instalimi i një Gushke për WC me kazan për shpëlarje me të gjithë elementët e nevojshëm të lidhëse fazonike për funksionalizim të plotë. I.log komplet	komplet	4.00	280.00	1,120.00 €
7.3	Blerja, transporti dhe instalimi i një pasqyre me të gjithë elementët e nevojshëm të lidhëse për funksionalizim të plotë. I.log komplet	komplet	5.00	50.00	250.00 €
7.4	Blerja, transporti dhe montimi i ujembledhësve horizontal .I.log, në copë	copë,	3.00	20.00	60.00 €
Gjithësejt punime të sanitaris:					2,680.00 €

VIII	PUNIMET E IZOLIMIT				
POS	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
8.1	Furnizimi , transportimi, punimi dhe vendosja e hidroizolimit horizontal me një lyerje të ftohtë (nidx ose te ngjajshem) në pllakën e dyshemesë të nyjeve sanitare me ngjitje në mure me lartësi min 50cm. . Izolimi punon përmes një substrati plotësisht të thatë dhe të pastër. Aplikohet shtresë ftohtë bitulite "A", shtrirja me furçë ose valak, në një temperaturë më të lartë se 10 gradë. Saldimi i shiritit të bitumit kryhet duke e ngrohur shiritin me flakëruar me flakë të hapur, duke përzier sipërfaqen e bitumit të sipërfaqes ngjësore dhe ngjiten me terrenin e vet për substrate. Vendosni kasetë në të gjithë sipërfaqen, me mbulesa prej 10 cm, i kushtoni vëmendje të veçantë lidhjeve të saldimit. I.logaritja për m2 për sipërfaqen izoluese.	m2	27.40	0.30	8.22 €
8.2	Blerja, furnizimi dhe punimi i termoizolime në të gjitha sipërfaqet e dyshemes së objektit me stiropor N4, me 1-3 cm . Izolimi vendoset në sipërfaqet plotësisht të thatë dhe të pastër në dysheme sipas detalit teknik të paraqitur në projekt për termoizolime. Në çmim duhet të llogaritet , PVC folia 2 mm, dhe shtresa prej 1 = 5 cm nga llaqi gjysëm i terur P- 1:3 me sipërfaqe të rregullt sipas standardit . I.log në m2 për sipërfaqen izoluese .	m2	27.40	1.00	27.40 €
Gjithsejt punët e izolimeve:					35.62 €

XI	PUNIMET E KERAMIKËS				
POS	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
9.1	Furnizimi me material, transporti si dhe punimi i pllakave keramike te dyshemeve te klasit te pare ,me veti fortësi mekanike prej 50N/mm2. Materiali te kete veti ndaj ngricave dhe acarit ,apsorbimi i gryerjes duhet te jete nen 0.5%. Hartinat kimike dhe rezistenca baze sipas NF EN ISO 10545-13. Pllaket duhet te vendosen standardeve. Punimi me ngjites eilesor Çmimi parshef edhe mveshjen e murev me h =10 cm. A1 profilet, fugimet si dhe te gjitha punimet deri ne finalizim. Dimenzionet dhe dizajnin e perzgjedh Investitori. I.log në m²	m2	27.40	12.50	342.50 €
9.2	Furnizimi me material, transporti si dhe punimi i pllakave keramike te mureve me ngjites te tualeteve dhe naltësi h=2.20 m, te klasit te pare ,me veti fortësi mekanike prej 50N/mm2. Pllaket duhet te vendosen sipas EN 13888 standardeve. Çmimi parshef edhe mveshjen ,fugimet si dhe te gjitha punimet deri ne finalizim. Dimenzionet dhe dizajnin e perzgjedh Investitori. I.log në m²	m2	82.65	10.00	826.50 €
Gjithsejt punët e keramikës :					1,169.00 €

X	PUNËT E NGJYROSJËS				
POS	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej

10.1	Furnizimi, transportimi dhe ngjyrosja e mureve dhe Pllafoneve të këllimave të brendshme me ngjyrë dispersive. Ngjyren e cakton organi mbikqyrës.1.log në m²	m2	165.00	0.80	132.00 €
10.2	Pastrimi, larja, dizinfektimi i gjithëmbarsheve hapësirave të brendshme të objektit pas përfundimit të punimeve. Materiali i cili pastrohet të largohet nga objekti.1.log në komplet	komplet	1.00	20.00	20.00 €
Gjithsej punët e ngjyrosjes:					152.00 €

REKAPITULLIMI I PUNIMEVE (TUALETET NË KAT)

I	PUNËT PËRGATITORE	1.800.00 €
II	PUNËT E DEMOLIMIT DHE RRËNIMIT	6.728.43 €
III	PUNËT E MURATUESËVE	272.80 €
IV	PUNIMET E ZIDRUKTITARIS (DYER,DRIJARE DHE PANELE NDARËSE)	2.319.00 €
V	INSTALIMET E UJËSJEJLËSIT	4.500.00 €
VI	INSTALIMET E KANALIZIMIT	4.000.00 €
VII	PUNIMET E SANITARISË	2.680.00 €
VIII	PUNIMET E IZOLIMIT	35.62 €
IX	PUNIMET E KERAMIKËS	1.169.00 €
X	PUNËT E NGJYROSJËS	152.00 €
TOTALI ME TVSH		23.656.85 €

PARAMASA E PARALLOGARIA

B. PUNËT E ANEKSIT TË SHKOLLËS SË MESME „R.BERISHA " DRAGASH

Kushte të përgjithshme:

Përshkrimi i punëve. Në përputhshmëri të plotë me standardet EC dhe ISO.

Masat e sigurisë: Duhet të jenë në nivelin më të lartë për arsye të ruajtjes së shëndetit të personave që punojnë dhe jetojnë afër punës. Pra në këto mënyrë duhet të bëhet rrethimi sa më i mirë i punës dhe vendosjes së materialeve në të si dhe të mirren masat e nevojshme të sigurisë (preventiva) hapësirave në mes të zonës nën ndërtim dhe zonave të tjera të cilat mbeten në shfrytëzim gjatë fazës së punimeve. Materialet nuk duhet të dalin jashtë rrethojës së punës.

Punështja të rrethohet me tabella prej llumarine dhe me konstruksion të përforcuar mirë në tokë. Para fillimit të punimeve punëkryesi duhet që në kosto të parasheh edhe çkyqjen e instalimeve ekzistuese në fillim të ekzekutimit të punimeve si dhe rikyqjen e instalimeve pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe masat e nevojshme për konservimin të instalimeve ekzistuese të cilat ngelen në shërbim (funksion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve.

Për çdo ndryshim të mundshëm në projekt gjatë realizimit të punimeve duhet të konsultohet organi mbikqyrës dhe projektanti.

Për secilin pozicion ku janë përmendur karakteristikat teknike të prodhuesit mund të përdoren materiale me karakteristika të ngjajshme të prodhuesve të ndryshëm në përputhje me standardet EC dhe ISO.

Të gjitha pozicionet përfshijnë, furnizimin me material, transportin, shkarkimin si dhe vuarjen në veper të materialeve për secilin pozicion

PUNIMET PREGADITORE					
Nr.	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
I	Inçizimi gjeodezik i lokacionit ekzistues Sipas Specifikacioneve teknike, si dhe përcjellja e punëve në vazhdimësi me instrumentet gjeodezike deri sa të përfundojnë punimet.1.log në m2.	m2	200.00	0.10	20.00 €

2	Furnizimi me material si dhe pregaditja e punimi i rrethojës së punishtes me tabelë prej lhamarinës dhe me konstrukcion të përfunduar mirë në tokë. Lartësia e rrethojës h=2.0 m llog në m'	m'	50.00	5.00	250.00 €	✓
3	Instalimi i zyreve të perkohshme në punishte (~12m²/copë) nga kontenjeret Vendosja e tyre bëhet në bashkëpunim me organin mbikqyres. llog në copë	copë	1.00	50.00	50.00 €	✓
4	Instalimi i përkohshëm i instalimeve komunale (uji, mbeturinat, rryma me njëisor- nga rrjeti, gjeneratori.) llog në komplet	komplet	1.00	50.00	50.00 €	✓
5	Instalimi i përkohshëm i tavolinës së armirueseve (tavolina me mbulesë deri 15 m gjatësi.) llog në komplet	komplet	1.00	850.00	850.00 €	✓
Gjithesëjt punime Pregaditore:					1,220.00 €	✓

II	PUNIMET DEMOLUESE ,TOKËSORE DHE TË MBUSHJES ZHAVORIKE				
POS.	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
